



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 558 Akti

Nr. 681 Vendimi
Tiranë, 7.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 5.7.2023, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artur Ismajlukaj**, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Etleda Çiftja kryesuese dhe Alma Faskaj anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

➤ *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2018.

- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj.
7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar² mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 5.5.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit në përputhje me nenet 35–40 dhe 45–47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
10. Subjekti Artur Ismajlukaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 19.5.2023. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 25.5.2023.
11. Në vijim, pas seancës dëgjimore dhe pasi Komisioni mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 26.5.2023 vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj, me qëllim kryerjen e disa verifikimeve shtesë të nevojshme për procesin e rivlerësimit.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2019.

12. Komisioni në datën 30.6.2023 vendosi të mbyllë hetimin administrativ shtesë, të njoftojë subjektin për rezultatet e këtij hetimi, duke i bashkëlidhur materialet e dosjes dhe dokumentet e administruara nga Komisioni për hetimin shtesë, të kryer në përputhje me nenet 35–40 dhe 45–47 të Kodit të Procedurave Administrative.
13. Subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit shtesë, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 3.7.2023.
14. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë përfundimisht subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 5.7.2023.
15. Për një proces të rregullt ligjor, subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seancat dëgjimore u zhvilluan në datat 25.5.2023 dhe 5.7.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.
17. Në seancën e parë të datës 25.5.2023, subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj u paraqit së bashku me përfaqësuesin ligjor. Në seancat vijuese, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt vetë, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Z. Artur Ismajlukaj ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës,

pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
21. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
22. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
23. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
 - ç. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
 - d. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
 - dh. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
 - e. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - ë. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë dy seancave dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
25. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

26. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.
27. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. Artur Ismajlukaj në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ku subjekti ka deklaruar pasuritë:
28. **Apartament banimi**, i ndodhur në komunën D, Tiranë, blerë në shumën 36.000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten.
29. Si burim krijimi në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar me: (i) të ardhurat nga paga si oficer i policisë gjyqësore nga viti 2005; (ii) me të ardhurat nga paga e bashkëshortes si mësuese nga viti 2006 e në vijim; (iii) 1.000.000 lekë dhuratë nga vjehri A.P.

Hetimi i Komisionit

30. ASHK-ja, Sektori i Legalizimit dhe i Planifikimit Urban³, ka referuar se në arkivin e këtij institucioni rezulton kërkesa e shtetasit Artur Ismajlukaj për t'u përfshirë në procedura legalizimi për apartamentin nr. **, pallati *, shkalla *, kati *, në D, Tiranë, ndërtuar nga shoqëria “**** – ****” sh.p.k., sipas kontratës së porosisë me nr. rep/kol. ***, datë 23.4.2011. Për shtetasin Artur Ismajlukaj është lëshuar leje e legalizimit me nr. ***, datë 23.9.2020, për objektin apartament me sip. 102.2 m², në D, Tiranë.
31. UKT-ja⁴ ka informuar se nuk rezultojnë të dhëna të regjistruara në emër të shtetasit Artur Ismajlukaj për kontrata të regjistruara për shërbime me Ujësjellës-Kanalizime.
32. FSHU-ja⁵ ka informuar se në emër të shtetasit Artur Ismajlukaj rezulton një kontratë furnizimi në instancën e Tiranës, me adresë Q, e hapur nga shoqëria “**** - ****” sh.p.k.
33. Nga hetimi i kryer mbi ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me firmën e ndërtimit apo me administratorin e saj, nga informacioni i ardhur nga Prokuroria e Tropojës⁶ nuk janë referuar të dhëna për ndonjë procedim të regjistruar pranë këtij institucioni në ngarkim të shoqërisë “**** - ****” sh.p.k. apo në emër të administratorit të saj, shtetasit H. Z.

Analiza e fakteve

34. Apartamenti është blerë në vitin 2011, përpara se subjekti të merrte detyrën e prokurorit. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se subjekti ka nënshkruar një kontratë

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2021.

⁴ Me shkresën nr. K-*** prot., datë 31.3.2021.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2023.

porosie me nr. *** rep., nr. ** kol., datë 23.4.2011, me shoqërinë ndërtuese “*** – ***” sh.p.k., përfaqësuar nga H.Z për blerjen e një apartamenti në vlerën 36.000 euro.

35. Në lidhje me regjistrimin e kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar⁷ se: *“Këtë pasuri e kam blerë në datën 23.4.2011 dhe është regjistruar në muajin tetor të vitit 2020. Nga ana e ndërtuesit, subjekti “*** - ***” sh.p.k., është marrë përsipër ndërtimi dhe regjistrimi i objektit, ku përfshihet dhe apartamenti im. Nga ana e tij është bërë ndërtimi. Në fund të vitit 2013, administratori i këtij subjekti, shtetasi H.Z, është larguar dhe nga ana e disa banorëve të pallatit ku jetoj, është bërë kallëzim penal për shitjen disa herë të apartamenteve të tyre dhe, me sa kam informacion, ky shtetas është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, por që nuk disponoj vendim, pasi kam marrë informacion nga mediat në lidhje me dënimin e tij. Së bashku me disa banorë të këtij pallati kemi tentuar disa herë që të bëjmë të mundur regjistrimin e apartamentit në fjalë, por që ka qenë e pamundur, pasi ne kemi qenë të pajisur me kontratë porosie dhe nuk kemi pasur kontratë shitjeje. Në datën 20.10.2020 është bërë i mundur regjistrimi i kësaj prone me proces legalizimi, duke depozituar lejen e legalizimit dhe vërtetimin e pronësisë.”*
36. Në lidhje me mënyrën e pagesës për blerjen e apartamentit, subjekti ka shpjeguar⁸ se: *“Pagesat për blerjen e këtij apartamenti janë kryer cash prej meje në shumën 33.000 euro, për të cilën disponoj dhe faturat përkatëse, ndërsa pjesa tjetër prej 3.000 euro është kryer në një afat më të gjatë, duke paguar çdo muaj dhe, për shkak të pagesave të vogla të kryera çdo muaj, nuk janë marrë fatura”.*
37. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, për pagesat e kryera subjekti ka depozituar 3 dokumente:
- mandat arkëtimi datë 23.4.2011, në shumën 5000 euro;
 - mandat arkëtimi datë 14.5.2011, në shumën 15.000 euro;
 - mandat arkëtimi datë 3.10.2011, në shumën 13.000 euro.
38. Në lidhje me shpenzimet e mobilimit të apartamentit⁹ ato janë përfshirë në analizën financiare, të shpërndara në vitet 2014 dhe 2015, në përputhje me deklaratimet e subjektit se ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2014.

Burimi i krijimit

39. Në deklaratën *Vetting*, në lidhje me burimet, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar me:
- të ardhurat nga paga e subjektit si oficer i policisë gjyqësore nga viti 2005;
 - të ardhurat nga paga e bashkëshortes si mësuese nga viti 2006 e në vijim;
 - dhurimin e 1.000.000 lekëve nga vjehri, z. A.P.
40. Në deklaratën e parë të vitit 2014, subjekti për këtë pasuri ka deklaruar si burim të ardhurat e krijuara nga paga e tij si OPGJ dhe të ardhurat e bashkëshortes, si dhe kursime të tyre përpara

⁷ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me email-in e datës 23.11.2022.

⁸ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur në datën 23.11.2022.

⁹ Në përgjigjet e pyetësorit standard.

fillimit të detyrës, pa cilësuar dhuratën e vjehrrit në shumën 1.000.000 lekë. Për këtë shkak, Komisioni konstatoi se nuk përputheshin deklaratimet e subjektit në lidhje me burimet e krijimit.

41. Për dhuratën e vjehrrit në shumën 1.000.000 lekë, në dosjen e subjektit rezulton njëdeklaratë noteriale me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 5.2.2016, lëshuar nga shtetasi A.P (babai i bashkëshortes së subjektit), ku ka deklaruar se në maj të vitit 2011 ka derdhur në llogarinë e dhëndrit të tij Artur Ismajlukaj shumën prej 1.000.000 lekësh nëpërmjet Raiffeisen Bank, shumë të cilën ia ka dhuruar për blerjen e një apartamenti. Z. P deklaron në këtë akt se shumën e parave e ka siguruar pjesërisht nga kursimet e tij dhe pjesërisht nga shumat e dërguara nga djali i tij si rezident në Angli.
42. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se vjehri i subjektit, shtetasi A.P, ka derdhur në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank, në datën 17.5.2011, shumën *cash* prej 1.000.000 lekësh. Kjo shumë është transferuar më pas nga llogaria e subjektit tek shtetasi G.S.M.
43. Për këtë transfertë, subjekti ka shpjeguar¹⁰ se: *“Me shtetasin G.M kam lidhje familjare dhe transfertat është bërë për arsye që këtë shumë ta këmbente në monedhën euro, për shkak se unë kam qenë në Tropojë dhe të kisha mundësi që kur të vija, ta merrja shumën në fjalë të këmbyer në monedhën euro, me qëllim kryerjen e pagesës për apartamentin”*.
44. I pyetur nga Komisioni në lidhje me burimet e krijimit për dhuratën e vjehrrit në shumën 1.000.000 lekë, subjekti ka shpjeguar¹¹ se: *“Shtetasi A.P ka qenë i punësuar në institucionin e F.F të Z.M që nga viti 2001 deri në vitin 2015, kur dhe ka dalë në pension. Subjekti ka depozituar dokumentacion të llogarive të tij në bankën Raiffeisen për periudhën nga viti 2005 e në vijim. Në lidhje me kunatin, i cili jeton në Angli që nga viti 1998, e kam të pamundur të sjell dokumente justifikuese për transfertat e kryera nga ana e tij kundrejt babait të tij, shtetasit A.P/vjehri im, për shkak se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga momenti që janë kryer këto transfertat”*.
45. Për burimet e ligjshme të vjehrrit të subjektit, në dosjen e ILDKPKI-së rezulton nxjerrje e llogarisë së z. A.P në monedhën lekë dhe GBP nga Raiffeisen Bank, e datës 14.10.2016. Nga këto të dhëna bankare ka rezultuar se të ardhurat e këtij shtetasi të transferuara nga djali i tij (E.P) për periudhën 2005 – 2011 janë rreth 114.680 GBP.

Nga hetimi mbi burimet e krijimit të pasurisë apartament ka rezultuar se:

a. Për të ardhurat e krijuara nga subjekti dhe bashkëshortja

¹⁰ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur në datën 23.11.2022.

¹¹ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur në datën 23.11.2022.

46. ISSH-ja¹² ka depozituar të dhëna për të ardhura të përfituara nga punësimi i rregullt i shtetasve Artur dhe E. Ismajlukaj nga janari 2012 e në vijim.

b. Mbi burimet ligjshme të dhuruesit (të vjehrrit të subjektit)

47. Sikurse ka shpjeguar subjekti, për blerjen e apartamentit nga vjehri i tij, z. A.P, i është dhuruar shuma prej 1.000.000 lekësh, për të cilën është hetuar nga Komisioni si vijon:

48. ISSH¹³ ka referuar të dhëna për punësimin e:

- Z. A.P pranë Shoqërisë së parë Financiare të Zhvillimit - *** sh.a. që nga janari 2012 – korrik 2015, kur del në pension me pension mujor në shumën 35.541 lekë;

- Znj. S.P, e punësuar pranë Zyrës Arsimore Mat, që nga janari 2012 – shtator 2013, kur dhe ka dalë në pension, me pension mujor në shumën 28.170 lekë.

49. Raiffeisen Bank¹⁴ ka depozituar të dhëna bankare të z. A.P, nga ku rezulton se ky shtetas në datën 7.4.2021 dispononte pranë kësaj banke llogari në shumën 152.235 lekë, në shumën 10.003 euro dhe në shumën 9,68 GBP. Llogaritë e z. A.P janë çelur në Raiffeisen Bank që në vitin 2005 në monedhën lekë dhe GBP, të cilat janë kredituar e debituar rregullisht.

50. FSHU-ja¹⁵ ka konfirmuar se në emër të:

- Z. A.Z.P rezulton një abonent me kontratë furnizimi me adresë në rrugën “R.P.M”, Burrel;

- Në emër të z. A.P identifikohet një abonent me kontratë furnizimi me adresë në rrugën “S.Z”, Tiranë.

51. UKT-ja¹⁶ ka informuar se në emër të z. A.Z.P rezulton kontrata e furnizimit për objektin me adresë në rrugën “S.Z”, Tiranë, me status aktiv në kategorinë konsumator familjar.

52. DPSHTRR-ja¹⁷ ka informuar se z. A.Z.P nuk ka automjet të regjistruar pranë këtij institucioni.

53. ASHK Tirana Veri¹⁸ ka informuar se në emër të z. A.Z.P figurojnë të regjistruara pasuritë:

- apartament me sip. 103 m², z. k. ***, vol. **, f. ***;

- garazh me sip. 21 m², z. k. ***, vol. **, f. ***.

54. Komisioni ka hetuar në lidhje me pasuritë e mësipërme, të blera nga vjehri i subjektit.

55. Pas vlerësimit të dokumentacionit të administruar, rezultoi se z. P (vjehri i subjektit) ka disponuar burime të mjaftueshme financiare për investimet e tij dhe dhënien e dhuratës, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

¹⁶ Me shkresën nr. K-*** prot., datë 31.3.2021.

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021.

¹⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.6.2021.

56. Komisioni kreu një analizë financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e apartamentit, duke analizuar elementet si vijon:
- të ardhurat e dokumentuara të subjektit nga pagat që nga viti 2005 e në vijim;
 - të ardhurat e dokumentuara të bashkëshortes që nga viti 2007, vit i martesës me subjektin;
 - mundësia e tij bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti në lidhje me dhuratën nga vjehri në shumën prej 1.000.000 lekë.
57. Nga hetimi i Komisionit janë administruar llogaritë bankare të z. A.P pranë Raiffeisen Bank në lekë dhe GBP. Në nxjerrjen e llogarisë në lekë duken qartë kreditimet nga pagat në vite, mbi bazën e të cilave janë bërë dhe përlllogaritjet në analizën financiare të mundësisë së dhuruesit.
58. Në llogarinë në paund britanik, kanë rezultuar një numër transfertash nga djali i tij, z. E. P, por subjekti nuk arriti të depozitojë dokumentacion për të provuar ligjshmërinë e krijimit të shumave të ardhura nëpërmjet sistemit bankar, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare të vjehrit për shumën e dhuruar prej 1.000.000 lekësh.
59. Komisioni analizoi të ardhurat e dokumentuara dhe shpenzimet për dhuruesin A.P dhe bashkëshorten e tij për periudhën 2008 – 2011.
60. Shpenzimet jetike për periudhën janë përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së për tre persona, nisur nga fakti se në certifikatën familjare prindërit e bashkëshortes kanë edhe një djalë në trungun familjar, S. P, i cili në vitin kur i është dhënë kjo dhuratë subjektit, ka qenë 22 vjeç.
61. Nga analiza e kryer nga Komisioni rezultoi se dhuruesi ka disponuar mjaftueshëm burime të ligjshme financiare të krijuara nga puna e tij për shumën e dhuruar prej 1.000.000 lekësh në vitin 2011.
62. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare të subjektit mbi burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit, ku u analizuan të ardhurat neto, shpenzimet e jetesës për dy persona, për subjektin dhe bashkëshorten¹⁹, si dhe shpenzimet e udhëtimeve sipas të dhënave të sistemit TIMS për periudhën 2005 – 2012.
63. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, subjekti ka rezultuar me balancë pozitive në shumën 1.967.668 lekë. Për rrjedhojë, subjekti ka disponuar mjaftueshëm burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament, edhe nëse nuk do konsideronim si burim dhuratën e vjehrit në shumën 1.000.000 lekë.

Konstatime të Komisionit për pasurinë apartament

64. Nga hetimi i kryer për pasurinë apartament ka rezultuar se:
- Subjekti ka pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2011;

¹⁹ Fëmija i parë i subjektit ka lindur në vitin 2015.

- Në deklaratën *Vetting* është deklaruar si burim shtesë dhurata nga vjehri në shumën 1.000.000 lekë, burim i cili nuk ishte deklaruar nga subjekti në deklarin e tij të parë të pasurisë në vitin 2014.

65. Përsa i përket mospërputhjes lidhur me burimet e krijimit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

66. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e datës 19.5.2023 ka pranuar se ka mospërputhje ndërmjet deklarimeve të subjektit në kohë të ndryshme për burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke shpjeguar se: *“jemi në kushtet e mosdeklarimit për shkak të harresës apo pakujdesisë dhe në asnjë rast në kushtet e mosdeklarimit me qëllim fshehjen e burimit apo të të ardhurave të krijuara”*.

67. Subjekti ka kërkuar që Komisioni të marrë në konsideratë faktin se jemi në kushtet e veprimeve financiare, të cilat janë kryer nëpërmjet sistemit bankar, çka provon vullnetin e subjektit të rivlerësimit për të qenë transparentë në lidhje me krijimin dhe burimin e të ardhurave. Së dyti, sikurse i ka rezultuar edhe vetë Komisionit në rezultatet e hetimit, dhuruesi ka pasur burime financiare të mjaftueshme dhe të ligjshme për të bërë dhuratën në shumën e deklaruar nga subjekti.

Vlerësimi i Komisionit

68. Komisioni, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e subjektit për pasurinë apartament në Tiranë, vlerëson se subjekti ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* dhuratën e vjehrit prej 1.000.000 lekësh, ndërsa në deklaratën periodike para fillimit të detyrës të vitit 2014 nuk e ka deklaruar këtë dhurim dhe kjo mospërputhje vlerësohet si një pasaktësi në plotësimin e deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2014, e saktësuar në deklaratën *Vetting*, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, si një mundësi që ky ligj u dha subjekteve nëpërmjet kësaj deklarate për të saktësuar deklarinimet e tyre në vite.

69. Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi e konstatuar, për aq kohë sa nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, nuk ngre peshë në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Mbështetur ky qëndrim edhe në faktin se edhe nëse Komisioni nuk do ta konsideronte dhuratën e vjehrit si një prej burimeve për blerjen e kësaj pasurie, përsëri analiza financiare do të rezultonte me balancë pozitive, çka tregon për mjaftueshmëri burimesh të ligjshme nga ana e subjektit.

70. Përfundimisht u konkludua se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar me vërtetësi pasurinë apartament të ndodhur në një zonë periferike të Tiranës dhe ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE NGA PAGA

71. Lidhur me të ardhurat nga pagat, nga verifikimi i deklarinimeve të subjektit evidentohet se:

Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat e realizuara në vite nga punësimi i tij si prokuror dhe OPGJ, si dhe nga punësimi i bashkëshortes së tij. Në lidhje me këtë konstatim subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit

72. Subjekti ka shpjeguar se ai dhe bashkëshortja kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore vetëm në një vend pune dhe të paguar nga buxheti i shtetit. Nuk jemi në kushtet kur mosdeklarimi ka për qëllim fshehjen e burimeve për të ardhurat. Pasaktësia në deklaram është pasojë e interpretimit të gabuar të ligjit nga subjekti i rivlerësimit, i cili në momentin e deklaramit ka vlerësuar si të panevojshëm deklaramin e të ardhurave, të cilat burojnë nga buxheti i shtetit dhe janë lehtësisht të verifikueshme. Komisionit i janë vënë në dispozicion vërtetimet e pagave, si dhe llogaritë bankare për subjektin dhe për bashkëshorten, dokumentacion i analizuar nga Komisioni në analizën financiare të vlerësimit të pasurisë.

Vlerësimi i Komisionit

73. Sipas dokumentacionit të administruar, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë qenë të punësuar të dy në institucione shtetërore, subjekti në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë nga viti 2005 e në vijim dhe bashkëshortja ka qenë e punësuar pranë Zyrës Arsimore Mat nga viti 2006 e në vijim. Të dyja këto institucione kanë lëshuar vërtetime në lidhje me të ardhurat në vite të krijuara nga subjekti dhe bashkëshortja e tij. Komisioni ka vlerësuar se mosdeklarimi i të ardhurave nga pagat e krijuara në vite në deklaratën *Vetting* është një pasaktësi në deklaram, pasi subjekti nuk mund të ketë patur si qëllim fshehjen e tyre.

74. Automjet në përdorim gjatë vitit 2016

Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përdorimin e automjetit me targë AA *** NC, në pronësi të shtetasit S. K pa prokurë apo akt përdorimi, pa shpërblim dhe për një periudhë të shkurtër kohore në vitin 2016. Në këtë periudhë subjekti nuk ka pasur mjet në pronësi. Subjekti ka deklaruar se me pronarin e automjetit ka pasur një lidhje shoqërore.

Hetimi i Komisionit

75. Komisioni hetoi mbi automjetin në përdorim, duke kërkuar informacion pranë DPSHTRR-së²⁰, e cila ka depozituar dosjen e plotë të automjetit me targë AA *** NC të tipit "F.F", me vit prodhimi 2006. Nga aktet rezulton se ky automjet është regjistruar në emër të z. S.K në datën 1.4.2016. Nga dosja rezulton se ky shtetas e ka blerë automjetin në datën 14.3.2016, në shumën 1.500 euro; dogana e paguar nga shtetasi S.K në datën 22.3.2016, në shumën 79.479 lekë; ky automjet i është shitur një shtetasi në datën 27.10.2017, në shumën 2.600 euro.
76. Subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 29 herë jashtë Shqipërisë, me automjetin në pronësi të shtetasit S.K, ndërsa pronari i këtij automjeti nuk ka udhëtuar asnjëherë jashtë vendit me këtë automjet. Referuar policave të sigurimit, subjekti ka qenë përdorues i këtij automjeti për

²⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.3.2023.

periudhën 2016 dhe 2017. Ky automjet për herë të parë është regjistruar në emër të z. S.K në vitin 2016.

77. Subjekti u pyet nga Komisioni për qëllimet e udhëtimit me këtë automjet në pikat kufitare Qafë-Prush dhe Qafë-Morinë. Subjekti ka shpjeguar²¹ se: “*Qëllimi i lëvizjes me këtë automjet në pikat kufitare Qafë-Prush dhe Qafë-Morinë ka qenë për të lëvizur në drejtim të Tiranës dhe anasjelltas pasi, siç deklarova dhe me sipër, ka qenë e vetmja mënyrë për të shkuar në Tropojë dhe anasjelltas, pasi rrugët për të shkuar në Tropojë janë të pakalueshme. Siç kam deklaruar dhe në pyetësorët e mëparshëm, kalimi në Kosovë është i detyrueshëm dhe pothuajse të gjitha hyrjet në Kosovë janë me qëllim për në drejtim të Tiranës apo anasjelltas, pasi kam pasur familjen në Tiranë”.*
78. DPSHTRR-ja²² dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit²³ kanë informuar se shtetasit Artur Ismajlukaj dhe E. Ismajlukaj nuk kanë automjete në pronësi.

Konstatime të Komisionit për automjetin

79. Në lidhje me automjetin në përdorim, Komisioni ka konstatuar se:
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë automjet në përdorim.
- Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, në prapësime subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit në prapësime

80. Subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi prej tij në deklaratën *Vetting* të përdorimit të automjetit gjatë vitit 2016 nuk ka pasur për qëllim fshehjen e përdorimit të tij. Ky pretendim i tij provohet nga fakti se gjatë përdorimit të mjetit nga ana e subjektit të rivlerësimit është bërë në çdo rast regjistrimi i mjetit në pikat e kalimit kufitar, si dhe është regjistruar polica e sigurimit të detyrueshëm në emër të vetë subjektit të rivlerësimit. Mosdeklarimi i përdorimit të këtij mjeti është pasojë nga njëra ana e mungesës së njohurive të plota e të sakta të subjektit në plotësimin e deklaratës së pasurisë, për shkak edhe të mungesës së eksperiencës dhe, nga ana tjetër, e pakujdesisë.

Vlerësimi i Komisionit

81. Komisioni, nisur nga fakti se subjekti përdorimin e këtij automjeti gjatë vitit 2016 e ka deklaruar vetë në pyetësorin standard si pasuri në përdorim, vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën *Vetting* i automjetit në përdorim i tipit “Ford Focus” është një pasaktësi në plotësimin e deklaratës *Vetting* nga ana e subjektit të rivlerësimit, e cila nuk ngre peshë, për sa nuk u konstatua të ketë patur për qëllim fshehjen.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

82. Nga vlerësimi në tërësi i deklarimeve në deklaratën *Vetting* ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë në pronësi apartament, i ndodhur në komunën D,

²¹ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me *email*-in e datës 15.3.2023.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021.

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021.

Tiranë, dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklarim të rremë. Nga analizimi i të ardhurave të dokumentuara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka disponuar burime të ligjshme për krijimin e pasurisë, mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e likuiditeteve për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar në ligj. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

II. KONTROLLI I FIGURËS

83. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
84. Në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar në datën 2.11.2017 raportin²⁴ mbi kontrollin e figurës, me konstatimin mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj.
85. Në vijim, AKSIK-ja ka dërguar²⁵ një raport të dytë në datën 20.5.2021, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, duke dërguar informacion në kohështirje përpara dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, ku dyshohet përfshirje në veprime korruptive në vitet 2014–2016 të subjektit të rivlerësimit Artur H. Ismajlukaj, si dhe mbi dyshime për kontakte të papërshtatshme.
86. Në përfundim, AKSIK-ja ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Artur H. Ismajlukaj.

Hetimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

87. Komisioni në janar të vitit 2023 ka kërkuar përditësim të të dhënave për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj, nga ku nuk rezultuan të dhëna shtesë.
88. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
89. Informacionet e marra nga institucionet ligjzbatuese janë verifikuar nga Komisioni dhe të dhënat e rezultuara nga hetimi i kryer janë trajtuar në pikën IV “Gjetje të tjera” të këtij

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, është përcjellë në Komisionin raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Artur H. Ismajlukaj, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

²⁵ Është dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. *** prot., datë 20.5.2021, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 11.6.2021.

vendimi, pasi nga një hetim i thellë dhe i gjithanshëm nuk rezultoi ndonjë e dhënë për kontakt të papërshtatshëm të subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

90. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më 28.2.2023 ka protokolluar shkresën me nr. *** prot. të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), me objekt “Gjetje”, në të cilën referohet se:

i. Nga baza e të dhënave të sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit më 8.1.2017, ora 11:13, ka kaluar kufirin shqiptar me një automjet (AA *** LB) në pronësi të shtetasit K.J (pronësia është konfirmuar nga baza e të dhënave të AMF) i datëlindjes 22.2.1975 dhe i drejtuar nga A.T;

K.J u shpall fajtor më 3.1.2016 nga Gjykata e Rimit - Ufficio G.I.P (në Itali) për 5 akuza për shitje të paligjshme të lëndëve narkotike dhe një akuzë për armëmbajtje pa leje dhe u dënua me 4 vjet e 2 muaj paraburgim dhe gjobë prej 26.000 euro, si fajtor për disa vepra penale si vijon:

- shitje e lëndëve narkotike, si vepër e vazhdueshme përgjatë vitit 2013, në zonat e B, I. M dhe rrethinat e R-t;

- mbajtje e paligjshme e armëve deri më 17 prill 2013, në zonat e B, I.M dhe rrethinat e R-t; Ky vendim i sipërpërmendur ka marrë formë të prerë dhe detyrues më 8.11.2016.

ii. Pesë, nga gjashtë veprat penale për të cilat J u shpall fajtor, duhet të konsiderohen sipas leximit të kombinuar të nenit 3, pika 15 e ligjit të *Vetting*-ut me nenin 3 (1) (c) të ligjit nr. 10192/2009 të Republikës së Shqipërisë dhe janë të rëndësishme për procesin e rivlerësimit të këtij subjekti rivlerësimi, pasi dispozitat e nenit 283 dhe 283/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë përmban sjellje për të cilën J u shpall fajtor në Itali, sipas nenit 73 të DPR 309/90 të Republikës së Italisë;

iii. Marrëdhënia midis shtetasit K.J dhe subjektit të rivlerësimit do të hetohet më tej si relevante për qëllim të vlerësimit të figurës dhe vlerësimin tërësor të çështjes.

91. Vëzhguesi ndërkombëtar ka marrë dijeni se shtetasi K.J është ekstraduar në Itali me kërkesë të autoriteteve italiane.

Konkluzion i vëzhguesit

92. Vëzhguesi referon se është e rëndësishme për qëllimin e rivlerësimit të këtij subjekti rivlerësimi që të sqarohen më tej marrëdhëniet e shtetasit Ismajlukaj me shtetasin J, për të verifikuar nëse ka pasur ndonjë kontakt mes z. J dhe z. Ismajlukaj dhe, në këtë rast, arsyet e mosdeklarimit të kontakteve të tilla nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e tij.

93. Situata në fjalë duhet të merret në konsideratë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vlerësimin tërësor, pasi mund të cenojë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

94. Nga një verifikim i thjeshtë rezulton se informacioni për ekstradimin e shtetasit K.J, i dënuar për trafik lëndësh narkotike, është bërë publik nga burime të hapura dhe në median online në datën 12.9.2015, me artikull: “Ekstradohen drejt Italisë dy shqiptarë, ishin në kërkim ndërkombëtar” etj.
95. Komisioni, nisur nga gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe nga konstatimet e AKSIK-së, ka zhvilluar një hetim të gjithanshëm, për të verifikuar nëse ka pasur ndonjë kontakt mes subjektit të rivlerësimit dhe personit të përfshirë në krimin e organizuar.
96. Nga verifikimi i të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS, u evidentua se më 8.1.2017, ora 11:13, subjekti i rivlerësimit ka kaluar kufirin shqiptar me një automjet (me targë AA *** LB) në pronësi të shtetasit K.J.
97. Nga hetimi rezultoi se shtetasi K.J, për shkak të dënimit të tij sipas informacionit të depozituar nga vëzhguesi ndërkombëtar si më sipër, është ekstraduar në Itali, në datën 11.9.2015. Për procedurat e ekstradimit të tij, Prokuroria e Përgjithshme²⁶ ka informuar se ky institucion ka mbajtur korrespondenca me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatën e këtij rrethi, të cilat kanë ndjekur procedurat për masën e sigurimit “arrest me burg” dhe “ekstradimin” e këtij shtetasi.
98. Subjekti është pyetur në lidhje me shtetasin K.J, si dhe iu kërkuan shpjegime për marrëdhënien me këtë shtetas. Subjekti ka shpjeguar²⁷ se: *“Shtetasin K.J nuk e njoh dhe nuk kam marrëdhënie të asnjë lloji me këtë shtetas. Siç kam deklaruar dhe më parë, kam udhëtuar me automjetin me targë AA *** LB, pasi e ka pasur në përdorim shtetasi Y.V. Në kohën kur kemi bërë këtë udhëtim, Y.V ishte në detyrën e shefit të Seksionit të Krimeve të Rënda, në Komisariatit e Policisë Tropojë. Me këtë automjet shtetasi Y.V ka ardhur në rrethin e Tropojës në datën 4.1.2017, kjo referuar sistemit TIMS. Sqaroj se duke qenë se nuk e kam njohur shtetasin K.J dhe, si rrjedhojë, nuk kam pasur mundësi që ta di që ky shtetas ka qenë i dënuar. Është hera e parë që i dëgjoj dhe emrin.”*
99. Komisioni ka kërkuar informacion pranë kompanive të telekomunikacionit, për të verifikuar komunikimet telefonike të mundshme të subjektit të rivlerësimit me shtetasin K.J për periudhën 2014 – 2017.
100. Shoqëritë “O.A” sh.a.²⁸ dhe “V.A” sh.a.²⁹ kanë informuar se bazuar në nenin 101 të ligjit 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë dhe administrojnë të dhënat për pajtimtarët e tyre për një afat 2-vjeçar. Për pasojë, informacioni i kërkuar nga Komisioni nuk është vënë në dispozicion nga këto shoqëri.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023.

²⁷ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me email-in e datës 15.3.2023.

²⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.4.2023.

²⁹ Me shkresën nr. ***.

101. Komisioni ka hetuar në lidhje me automjetin me targë AA *** LB (në pronësi të shtetasit K.J), nëse ky automjet ka qenë i konfiskuar, sekuestruar apo bllokuar nga institucionet shtetërore, nisur nga fakti se automjeti kur ka udhëtuar subjekti i rivlerësimi, drejtohej nga shtetasi Y.V, i cili mbante detyrën e shefit të seksionit të krimeve në Komisarriatin e Policisë Tropojë.
102. Drejtoria Vendore Kukës³⁰ ka informuar se nuk disponon asnjë informacion në lidhje me ndonjë masë bllokimi, sekuestrimi apo konfiskimi ndaj automjetit me targë AA *** LB.
103. Komisarriati i Policisë Tropojë³¹ ka informuar se automjeti me targë AA *** LB nuk rezulton të jetë i bllokuar pranë këtij institucioni.
104. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit³² ka informuar se automjeti me targë AA *** LB nuk rezulton që të ketë ndonjë masë bllokimi, sekuestrimi apo konfiskimi.

Konstatime të Komisionit

105. Bazuar në informacionet e institucionit verifikues të figurës, në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe nga hetimi i kryer, Komisioni ngriti dyshime për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me shtetasin K.J, person i përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me pikën 3 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.
106. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit

107. Në lidhje me konstatimin e AKSIK-së për papërshtatshmëri në vijimin e detyrës, subjekti ka shpjeguar se: *“Me njoftimin e rezultateve të hetimit më është kërkuar të jap sqarime në lidhje me raportin e AKSIK-së dhe në mënyrë të përmbledhur deklarohet se nuk rezulton asnjë shpjegim apo fakt mbi arsyet që AKSIK-ja ka ndryshuar konkluzionin nga i përshtatshëm në i papërshtatshëm dhe nuk kam dijeni dhe as jam njohur me dokumentet ku mbështetet ky konkluzion i AKSIK-së.*
108. *Raporti i dytë i këtij institucioni është joserioz, i pabazuar dhe jo i drejtë, për më tepër që ky raport u referohet të “dhënave” për kohën përpara se të dilte raporti i parë nga i njëjti institucion, ku AKSIK-ja fillimisht ka konkluduar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.*
109. *Në kushtet e mungesës së provave ku mbështetet konkluzioni i këtij raporti, e bën të pamundur mbrojtjen time dhe kjo cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor. I vetmi shpjegim që mund të japë përpara Komisionit në këtë moment, është se gjatë karrierës sime si oficer i policisë gjyqësore dhe prokuror kam ushtruar detyrën me përkushtim dhe korrektësi, duke zbatuar vetëm ligjin. Unë kam plotësuar në mënyrë të saktë formularin e kontrollit të figurës, nuk kam pasur kontakte të papërshtatshme, si dhe nuk jam përpjekur të fsheh kontakte me*

³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2023.

persona të përfshirë në krimin e organizuar e, në këto kushte, i plotësoj të gjitha kriteret e parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 34–39 të ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës”.

110. Në lidhje me shtetasin K.J, subjekti, ndër të tjera, ka pretenduar se:

- *Shtetasi K.J është ekstraduar nga Shqipëria drejt Italisë në datën 12.9.2015. Nuk provohet që ky shtetas nga momenti i ekstradimit deri në datën kur kam udhëtuar me automjetin në pronësi të tij, të jetë futur apo të ketë qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, për pasojë ky fakt përjashton mundësinë e ndonjë kontakti me këtë shtetas.*
- *Nga provat e administruara nga Komisioni nuk u provua që unë dhe shtetasi K.J të kemi pasur njohje apo kontakte sipas kriterëve provuese të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.*
- *Nga informacionet e marra nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të thelluar, nga sistemi TIMS rezulton se automjeti me targë AA *** LB është përdorur për herë të parë nga shtetasi Y. V në datën 4.1.2017. Në mbështetje të shpjegimeve të mia, shtetasi Y.V ka lëshuar një deklaratë noteriale nr. *** rep., numër *** kol., datë 3.5.2023, depozituar para Komisionit si provë, ku deklaroi se: “...ky automjet është përdorur nga ana ime dhe se shtetasi Artur Ismajlukaj nuk ka pasur asnjë lidhje me këtë automjet, kjo lehtësisht e provuar, pasi unë kam hyrë në territorin e Shqipërisë dhe pikërisht në Tropojë nga pika e kalimit kufitar Qafë-Morinë të rrethit Tropojë në datën 4.1.2017 dhe, pasi kam qëndruar disa ditë në Tropojë, ku dhe kam qenë i punësuar në Komisarjatin e Policisë të këtij rrethi me detyrën e shefit të krimeve të rënda, jam kthyer përsëri në qytetin e Tiranës, ku dhe kam banuar në atë kohë. Në datën 4.1.2017 kam qenë i vetëm në automjetin me targë AA *** LB dhe, si rrjedhojë, në drejtimin e automjetit...”*

111. Subjekti ka vijuar të shpjegojë: “Unë kam udhëtuar me automjetin me targë AA *** LB vetëm në datën 8.1.2017. Nga analiza në tërësi e fakteve të mësipërme rezulton se:

*a) nuk kam qenë poseduesi i automjetit me targë AA *** LB; b) nuk kam qenë personi që ka marrë fillimisht automjetin me targë AA *** LB nga vendndodhja e tij fillestare, vendndodhje në të cilën mund të kishte kontakt me shtetasin K.J; c) nuk kam përdorur asnjëherë automjetin me targë AA *** LB, por kam qenë vetëm në cilësinë e pasagjerit, çka provon pretendimin tim për mospërdorimin e drejtpërdrejtë të mjetit e, për pasojë, mospasjen e kontakteve me shtetasin K.J”.*

112. “Pretendimi se unë si subjekt rivlerësimi duhet të isha në dijeni të faktit që automjeti me targë AA *** LB ishte në pronësi të një personi të përfshirë në veprimtari kriminale, është i pambështetur nga provat e administruara nga vetë Komisioni dhe nga ato të relatuara më lart. Pretendimi i qenies fakt publik i ekstradimit të shtetasit K.J dhe, për pasojë, edhe dijenisë së subjektit të rivlerësimit mbi veprimtarinë kriminale të këtij shtetasi, është i padrejtë dhe i pambështetur. Nuk ka asnjë provë që në vitin 2015 unë kisha njohje me shtetasin K.J, njohje e cila mund të çonte subjektin e rivlerësimit në mbledhjen dhe

memorizimin e informacioneve publike në lidhje me veprimtarinë kriminale të këtij shtetasi. Për sa kohë nuk mund të provohet që përpara vitit 2015 ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit K.J kishte njohje apo kontakte, nuk mund të ngrihet pretendimi për marrjen dijani nëpërmjet organeve mediatike të ekzistencës së shtetasit K.J e aq më tepër të ekzekutimit të një procedure ekstradimi në ngarkim të këtij shtetasi. Për më tepër, procedura e ekstradimit është ndjekur nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, organe me të cilat subjekti i rivlerësimit në kohën e ekzekutimit të procedurës nuk kishte asnjë lidhje të çfarëdo lloji”.

113. *“Sjellim në vëmendje të Komisionit se shtetasi K.J është dënuar me vendim të formës së prerë në shtetin italian vetëm në datën 8.11.2016, pra 60 ditë përpara datës së përdorimit të automjetit në pronësi të këtij shtetasi nga subjekti i rivlerësimit. E sjellim këtë fakt në vëmendje të Komisionit për të provuar që edhe në rastin hipotetik të njohjes së shtetasit K.J dhe subjektit të rivlerësimit, për aq kohë sa veprimtaria kriminale e të parit e, për pasojë, edhe vendimi i dënimit të tij, është realizuar dhe marrë në shtetin italian, subjekti i rivlerësimit do të ishte në kushtet e pamundësisë së marrjes dijani për aktivitetin kriminal dhe dënimin e shtetasit K.J”.*
114. *“Në deklaratën noteriale nr. rep/kol ***, datë 3.5.2023, shtetasi Y.V deklaron se automjetin me targë AA *** LB e ka marrë në përdorim nga i afërmi i tij E.K. Ky deklaram i analizuar në tërësi me të gjitha provat dhe deklaramet e tjera të shtetasit Y.V provojnë që unë jam përdorues rastësor i mjetit dhe se në momentin e përdorimit rastësor të tij nuk mund të kisha dijani për aktivitetin kriminal të pronarit të mjetit”.*
115. *“Deklarimet e shtetasit Y.V janë të njëjta me deklaramet e shtetasit E.K sipas aktit noterial nr. rep/kol ***, datë 3.5.2023. Ky shtetas ka deklaruar se “... automjetin me targë AA ***LB ia kam marrë shtetasit K.J me qëllim për ta përdorur për disa ditë. Datat e sakta nuk i mbaj mend, por di që ka qenë muaji janar 2017 dhe tek shtëpia ime në Mamurras ka ardhur çuni i hallës Y.V, i cili më ka thënë se po ikte për në Tropojë ku dhe ishte i punësuar në Komisariatën e Policisë. Pasi ka qëndruar disa kohë tek banesa ime ka dalë dhe unë i kam dhënë automjetin me targë AA ***LB, të cilin e kisha të parkuar në oborrin e banesës. Automjeti ishte i tipit fuoristradë dhe, duke qenë se ishte mot me dëborë në Tropojë, kushëriri ime Y.V e ka marrë dhe e ka mbajtur disa ditë dhe e ka kthyer. Shtoj se shtetasi Y.V nuk ka asnjë lidhje me shtetasin K.J dhe nuk e njeh...”.*
116. *“Në analizë të kriterëve të parashikuara nga pika 4 e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 rezulton se nuk mund të arrihet në përfundimin se unë si subjekt rivlerësimi kam pasur kontakte të papërshtatshme me shtetasin K.J”.*
117. Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të parashtruara, ka depozituar dokumentacion mbështetës:
 - deklaratat e shtetasit Y.V me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2023;
 - deklaratë e E.K me nr. *** rep., nr. *** kol, datë 3.5.2023;

- vërtetimin e Komisionit të Policisë Tropojë, me të cilin vërtetohet se shtetasi Y.V ka qenë i punësuar pranë këtij Komisioni për periudhën 23.12.2016 –1.3.2017, në pozicionin shef i seksionit të krimeve të rënda.

Vlerësimi i Komisionit

118. Trupi gjykues, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit në prapësime, si dhe dokumentacionin mbështetës të depozituar nga ana e tij, nga analizimi i të dhënave të administruara në dosjen e hetimit, në analizim të situatës objekt gjykimi, ka evidentuar disa rrethana të cilat duhen të konsiderohen në vlerësimin përfundimtar të kriterit të figurës, si vijon:
119. Në kohën kur subjekti ka udhëtuar me automjetin e shtetasit K.J, automjeti drejtohej nga Y.V dhe subjekti i rivlerësimit ishte pasagjer. Ka rezultuar se shtetasi Y.V e ka përdorur këtë automjet dhe në raste të tjera, e dhënë që për Komisionin konfirmon faktin që subjekti nuk ka pasur posedim personal të këtij automjeti.
120. Në periudhën që automjeti përdorej nga z. Y.V dhe subjekti pasagjer, shtetasi K.J vuante dënimin e tij në Itali, i ekstraduar në muajin shtator 2015. Ky fakt provon që në ditën kur subjekti ka udhëtuar me këtë automjet, në datën 8.1.2017 subjekti nuk ka pasur mundësi reale të kishte ndonjë kontakt me shtetasin K.J.
121. Në janar të vitit 2017, kur subjekti ka udhëtuar me shtetasin Y.V, ky i fundit ishte në detyrën e shefit të krimeve në komisionin e Tropojës. Sikurse subjekti ka shpjeguar, me këtë shtetas e ka lidhur marrëdhënia e punës, për shkak të grupeve hetimore që krijoheshin për ushtrimin e detyrave funksionale të secilit prej tyre. Në këto kushte, bëhet i besueshëm pretendimi i subjektit që marrëdhënia me Y.V ka qenë profesionale dhe për shkak të detyrës.
122. Procedurat e ekstradimit të shtetasit K.J janë ndjekur nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nuk provohet që subjekti i rivlerësimit formalisht të kishte ndonjë dënim për dënimin e këtij shtetasi në Itali.
123. Komisioni vlerëson se për të konstatuar që një subjekt rivlerësimi ka kontakte të papërshtatshme, duhet të merren parasysh rrethanat e parashikuara në pikën 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Mbi bazën e interpretimit të këtyre dispozitave, bazuar dhe në provat e rezultuara gjatë hetimit për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj, konstatohet se:
 - a. Nga ana e Komisionit nuk u provua asnjë e dhënë apo indicie për ekzistencën, qoftë edhe vetëm të një informacioni kontakt, fotografim, bisedë telefonike apo e dhënë e treguar nga një dëshmitar me shtetasin K.J;
 - b. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit apo ndonjë nga personat e lidhur të kishte ndonjë komunikim jorastësor me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar;

- c. Nuk rezultoi që subjekti apo persona të lidhur të kenë përfituar dhe as të kenë shkëmbyer ndonjë të mirë materiale të çfarëdo lloji me shtetasin K.J apo me persona të tjerë të konsideruar si kontakt të papërshtatshëm në kuptim të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016;
 - ç. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar apo subjekti të ketë bërë takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar.
124. Përfundimisht u konkludua se nga hetimi i Komisionit nuk u provua ndonjë kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të ligjit nr. 84/2016.
125. Për sa më sipër, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e dala nga hetimi i çështjes, në shpjegimet dhe provat e depozituara në prapësime, bazuar edhe në të dhënat e administruara nga autoritetet përgjegjëse për kontrollin e figurës, për një vlerësim sa më objektiv të çështjes, Komisioni çmon se nuk disponohen elemente të mjaftueshme provueshmërie për të përmbushur rrethanat e parashikuara në pikën 4, rrethana këto që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me standardet e kontrollit të figurës, sipas nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

126. Përfundimisht, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj ka plotësuar saktë deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga vlerësimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, të të gjitha provave dhe shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti në prapësime nuk u provua kontakti i papërshtatshëm.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

127. Raporti i ardhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:
1. formularit të vetëdeklarimit;
 2. të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
 3. të 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura me short sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
 4. të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së.
128. Raporti i vlerësimit profesional të prokurorit Artur Ismajlukaj është bazuar në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në vijim:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

I. GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

129. Formulari është plotësuar nga subjekti sipas udhëzimit të shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

b) Përvoja profesionale

130. Përvoja profesionale e subjektit të rivlerësimit:

- Me dekretin nr. 8605, datë 20.6.2014, të Presidentit të Republikës, emërohet Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.
- Me urdhrin nr. ***, datë 30.10.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, komandohet Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
- Me urdhrin nr.***, datë 14.3.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, komandohet drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.
- Aktualisht subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

c) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

131. Komisioni, pas analizimit të 3 dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti, nuk ka evidentuar problematika.

II. PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE PENALE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Komisioni ka analizuar 5 dosjet e përzgjedhura me short, në 2 prej tyre ka evidentuar sa vijon:

132. Dosja nr. 1, që i takon kallëzimit penal nr. **/2014 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, me datë vendimi 26.9.2014. Kjo çështje penale i përket periudhës së parë të rivlerësimit për subjektin Artur Ismajlukaj, në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.

Konstatim i Komisionit për dosjen 1.

133. Në lidhje me këtë dosje, Komisioni ka konstatuar se baza ligjore, mbi të cilën është marrë vendimi i mosfillimit, është e gabuar, pasi subjekti i rivlerësimit u referohet rasteve të pushimit të akuzës apo çështjes në përfundim të hetimeve paraprake dhe jo rasteve të mosfillimit të procedimit penal. Mosfillimi i procedimit penal duhej të vendosej në bazë të nenit 290, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale. Referenca ligjore e përdorur nga prokurori u referohet rasteve të pushimit të hetimeve.

134. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit në prapësime

135. Në lidhje me konstatimet e Komisionit subjekti ka shpjeguar se: *“Duke marrë në analizë vendimin, rezulton se ky i fundit në pjesën arsyetuese të tij argumenton dhe referon në praktikën dhe vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal. Për këtë shkak, vlerësojmë se në rastin konkret jemi në kushtet e një lapsusi, gjatë të cilit është vendosur gabimisht si bazë ligjore dispozita për pushimin e hetimeve dhe jo dispozita për mosfillimin e procedimit penal.”*

Vlerësimi i Komisionit

136. Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, si dhe referuar dhe vendimit të mosfillimit të procedimit të tij, Komisioni vëren se subjekti ka ngatërruar dispozitën mbi të cilën ka marrë vendimin, ndërkohë që në pjesën arsyetuese të këtij vendimi subjekti i është referuar parashikimeve ligjore të dispozitës së “mosfillimit të procedimit”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Për Komisionin ky vlerësohet si një gabim material për shkak të pakujdesisë që mund të ndodhë në rrethana normale dhe jo një praktikë pune e mangët e subjektit të rivlerësimit, që të ndikojë negativisht në vlerësimin profesional të tij.
137. Në lidhje me dosjen nr. 3 të analizuar, që i takon kallëzimit penal nr. **, datë 19.4.2016, regjistruar për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë. Dokumenti ligjor i hartuar nga subjekti “Vendim për pushimin e çështjes penale”, nr. **/2016, datë 31.5.2016.

Konstatimi i Komisionit për dosjen 3.

138. Komisioni pas analizimit të kësaj dosjeje ka konstatuar se:

Në vendimin për “Pushim të procedimit penal” nuk ka analizë ligjore për mungesën e elementeve të veprës penale dhe i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit në prapësime

139. Subjekti ka shpjeguar se: “Përfundimi i arritur nga Komisioni është pjesërisht i drejtë. Nga analiza e vendimit konstatohet se, ndonëse nuk janë cituar formalisht objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive, në vendim është arsyetuar dhe është bërë analiza e provave, e të dhënave të administruara, në vështrim të analizës së dispozitës penale përkatëse. Pas analizës ligjore dhe interpretimit të nenit 287 të Kodit Penal, është arritur në përfundimin se nuk ndodhemi para asaj vepre penale dhe as ndonjë vepre tjetër penale, për të cilat organi i prokurorisë ka detyrimin për të ushtruar ndjekjen penale. Nga të dhënat e administruara qartazi rezulton mungesa e veprës penale, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, shkak për të cilin subjekti nuk është ndalur në analizën formale të elementeve të kësaj figure vepre penale.

Vlerësimi i Komisionit

140. Komisioni çmon se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe, megjithëse nuk është analizuar në vendim mungesa e elementeve të veprës, subjekti ka bërë analizë të provave e fakteve dhe arsyeve se pse ka arritur në përfundimin se për rastin në shqyrtim nuk ndodhemi para veprës penale të “pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe as ndonjë veprë tjetër penale, për të cilat organi i prokurorisë ka detyrimin për të ushtruar ndjekjen penale. Në përfundim, Komisioni vlerëson se vendimmarrja e subjektit rezulton korrekte.

III. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

141. Nga verifikimi i të dhënave nga 23 prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë në Republikën e Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjimeve të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, si dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhëniet me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton që për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Artur Ismajlukaj:
- ✓ nuk ka pasur masa disiplinore lidhur me punën e kryer.
142. Nga institucioni i SHISH-it është dërguar informacioni nr. ***, datë 15.11.2016, lidhur me fenomenin e kultivimit të *cannabis sativa* në vend. Ekstrakte të këtij informacioni i janë përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë me shkresën nr. ***, datë 30.11.2016.
143. Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë³³ ka informuar se informacioni i SHISH lidhur me fenomenin e kultivimit të *cannabis sativa* në vend, i përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, është regjistruar në regjistrin e protokollit të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe
- ✓ nuk rezulton që të jenë bërë shënime vijuese në regjistër dhe as regjistrimi i ndonjë çështjeje penale.
144. Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë informon se për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Artur Ismajlukaj, nuk ka kallëzim apo procedim penal të regjistruar në ngarkim të tij. Nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).
145. Nga sektori i protokoll-arkivit pranë Prokurorisë së Përgjithshme konfirmohet se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj:

³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2023.

- ✓ nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj tij.
146. ILD-ja³⁴ ka informuar se pranë këtij institucioni për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj është administruar një ankesë me nr. *** prot., datë 5.2.2021, nga z. R.Sh. Pas shqyrtimit fillestar, ILD-ja me vendimin nr. ***prot., datë 11.11.2022, ka vendosur arkivimin e ankesës, për shkak se vepra penale për të cilën ishte bërë ankimi, ishte parashkruar. Ankuesi ngre pretendime për fakte dhe veprimtari të subjekteve të rivlerësimit, objekt i veprimtarisë së ILD-së, por që kanë ndodhur jashtë afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor.
147. ILD-ja³⁵ ka depozituar praktikën e kësaj anekese. Nga dokumentet bashkëlidhur ankesës rezulton se mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit B. Sh., në datën 30.5.2007, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë ka regjistruar procedimin penal nr. ***. për veprat penale “vrasje me paramendim” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake” (e parashikuar nga nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal), vepër pa autor. Procedimi penal bën fjalë për ngjarjen e ndodhur në datën 26.9.1995, në spitalin e qytetit Bajram Curri të rrethit Tropojë dhe pikërisht në sallën e urgjencës së spitalit ku është vrarë me armë zjarri në detyrën e mjekut shtetasi A. Sh. Nga hetimi ka rezultuar se kjo ngjarje është hetuar fillimisht në vitin 1995 dhe dosja penale përkatëse është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me të pandehur shtetasin B. S., por dosja penale është djegur në këtë gjykatë gjatë trazirave të vitit 1997 dhe nuk disponohet asnjë dokumentacion lidhur me përfundimin e gjykimit.
148. Pas kryerjes së veprimeve të mundshme hetimore në datën 12.7.2008, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë ka vendosur pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. ** të vitit 2007. Në vijim, pas rifillimit të hetimeve, në datën 18.4.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ** të vitit 2007, pasi ka rezultuar se ndjekja penale për veprën penale “vrasje me paramendim” të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal është parashkruar.
149. Nga aktet ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj, në cilësinë e prokurorit të çështjes, me vendimin e datës 18.4.2016 ka vendosur:
- Pushimin e procedimit penal nr. ** të vitit 2007, pasi nga materiali hetimor ka rezultuar se ndjekja penale për veprën penale “vrasje me paramendim”, parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal, është parashkruar;
 - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Konstatime të Komisionit

150. Nga analizimi i dosjes, Komisioni ka konstatuar se:

³⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2023.

³⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2023.

- Ankuesi/vëllai i viktimës nuk është njoftuar për vendimin e pushimit të procedimit penal, të vitit 2016, në përputhje me shkronjën “ë” të pikës 1 të nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale;
- Subjekti i rivlerësimit ka disponuar në vendimin e pushimit të procedimit të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit të adresuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërkohë që duhet të kishte adresuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

151. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, si dhe të depozitohet dokumentacion mbështetës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit në prapësime

152. Subjekti ka shpjeguar se sikurse pasqyrohet në rezultatet e hetimit administrativ për këtë çështje, në pikën 2 të vendimit të pushimit subjekti i rivlerësimit ka vendosur që ky vendim t’i njoftohet personit të interesuar. Në cilësinë e prokurorit të çështjes, subjekti i rivlerësimit ka për detyrë që të disponojë me vendim edhe për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në procedimin penal në cilësinë e ankuesit (vëllait të viktimës) apo personit të dëmtuar. Njoftimi i vendimeve është detyrë funksionale e sekretarisë së Prokurorisë. Veprimet administrative të prokurorit përfundojnë në momentin e dorëzimit të vendimit, në numër të mjaftueshëm kopjesh në sekretarinë e prokurorisë. Veprimet e mëpasshme janë detyrë e kësaj strukture administrative. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit nuk ka asnjë kontroll të drejtpërdrejtë administrativ apo hierarkik mbi veprimtarinë e sekretarisë; Duke marrë në konsideratë faktin që rasti i konstatuar nga Komisioni në dijeninë e subjektit të rivlerësimit nuk ka ndodhur më parë apo më pas dhe nga ana e familjarëve të viktimës nuk është kërkuar informacion në lidhje me procedimin penal. Subjekti i rivlerësimit me të drejtë ka prezumuar se ankuesit kishin marrë dijeni për vendimin e pushimit të procedimit dhe se njoftimi i vendimit nuk ishte realizuar nga sekretaria e prokurorisë, ashtu sikurse ishte disponuar në vendimin e pushimit.

Vlerësimi i Komisionit

153. Komisioni vlerëson se sikurse ka shpjeguar dhe subjekti, është detyrë funksionale e sekretarisë që të kryejë njoftimin e vendimit të prokurorit tek palët, por subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e duhur që sekretaria të kryente njoftimin e palëve të interesuara, sipas vendimit të tij, për më tepër që në periudhën e nxjerrjes së vendimit të pushimit të procedimit penal me nr. ** të vitit 2007 të datës 18.4.2016, subjekti ka mbajtur dhe detyrën e drejtuesit të Prokurorisë Tropojë.

154. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me konstatimin tjetër të Komisionit, se në vendimin e pushimit të disponuar prej tij ka referuar palën kallëzuese mbi ushtrimin e të drejtës së ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërkohë që gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

155. Komisioni vlerëson se ky gabim mund të ketë ardhur nga pakujdesia e subjektit, duke marrë në konsideratë faktin që subjekti ka punuar disa kohë si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë³⁶ dhe në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për të shqyrtuar vendimmarrjet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Ky gabim mund të ndodhë në rrethana normale nga një magjistrat mesatar.
156. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar³⁷ ka informuar se pranë këtij institucioni për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj në datën 4.4.2022 është administruar një material, me kallëzues shtetasin J.S, material i cili është dërguar për vlerësim në Prokurorinë e Përgjithshme.
157. Prokuroria e Përgjithshme³⁸ ka informuar se për çështjen e kallëzuar nga J.S, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e datës 24.4.2022 ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal lidhur me këtë kallëzim”.
158. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka informuar se në regjistrin e veprave penale
- ✓ nuk rezulton që në emër të shtetasit Artur Ismajlukaj të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

IV. ANALIZA E GJETJEVE

159. Komisioni nga analizimi i dosjeve të vëzhguara lidhur me kriteret e vlerësimit profesional ka rezultuar si më poshtë:

1. Aftësitë profesionale

160. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.
161. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Artur Ismajlukaj, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Në konkluzionet përfundimtare të dosjeve të shortuara arsyetohet në drejtim të provueshmërisë së faktit penal dhe përgjegjësisë penale, si dhe në drejtim të individualizimit të dënimit.

2. Aftësitë organizative

162. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar kompetencat që ligji i njuh prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore, ngritjen dhe

³⁶ Me urdhrin nr. **, datë 30.10.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, komandohet prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ku ka vazhduar deri më 14.3.2016.

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2023.

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2023.

përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me efekt të menjëhershëm.

Nga analiza e çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i tij është shprehur brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal, duke treguar eficiencë në përballimin e ngarkesës në punë.

163. Subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi ka pasur edhe funksione drejtuese e konkretisht prej muajit mars 2016 deri në fund të periudhës së rivlerësimit ka ushtruar funksionet e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë e, më tej, edhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës.
164. Subjekti i rivlerësimit ka administruar aktet procedurale përgjithësisht në mënyrë të rregullt, duke ruajtur një formë të caktuar të renditjes së tyre në fashikullin hetimor, që synon paraqitjen korrekte dhe të plotë të veprimtarisë së tij në aspektin e hetimit, kontrollit të vazhdueshëm të policisë gjyqësore dhe rritjes së transparencës ndaj publikut.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

165. Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 për subjektin e rivlerësimit nuk është marrë asnjë masë disiplinore.
166. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit prokurori Artur Ismajlukaj, si dhe nga aktet e vëzhguara konstatohet se nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.
167. Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Artur Ismajlukaj. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Artur Ismajlukaj, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

168. Nga aktet e vëzhguara nuk kanë rezultuar të dhëna për të verifikuar aftësitë e subjektit në komunikim, si dhe aftësinë e tij për të bashkëpunuar me kolegët.

❖ DENONCIME NGA PUBLIKU

169. Për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj janë administruar në total 4 denoncime, për 2 nga të cilat subjektit i janë kërkuar shpjegime.

Denoncim i shtetases C.B³⁹

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2018.

170. Kjo shtetase ka pretenduar se banorët e fshatit D në Tropojë kanë bërë një kallëzim penal për falsifikim të firmave të banorëve nga kryeplaku i fshatit në bashkëpunim me shoqërinë ndërtuese “G **”, me qëllim fillimin e punimeve për ndërtimin e një hidrocentrali. Denoncuesja ka pretenduar se tek personat që kanë firmosur kanë qenë 2 veta, të cilët në momentin kur ishte hartuar akti, kishin ndërruar jetë. Denoncuesja pretendon se prokurori i çështjes ka propozuar pezullim të çështjes për shkak të kalimit të afatit.
171. Subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes pas hetimit ka konstatuar se gjendej para faktit të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, por ka arsyetuar se për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, referuar dispozitës 186/2 të Kodit Penal, parashikohet një masë dënimi me burgim deri në 4 vjet. Që nga momenti i kryerjes së kësaj vepre kishin kaluar afërsisht 5 vite dhe, në referim të shkronjës “ç” të nenit 66 të Kodit Penal, kjo vepër penale ishte parashkruar dhe ka kërkuar pushimin e çështjes.
172. Komisioni për këtë çështje ka evidentuar se subjekti i rivlerësimit ishte në shkelje të nenit 66/ç të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, pasi në datën e depozitimit të kallëzimit penal, datë 5.3.2018, nuk ishte mbushur afati 5-vjeçar i parashkrimit të veprës penale “falsifikim i dokumenteve”.
173. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit në prapësime

174. Në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka shpjeguar si vijon: *“gjetja e Komisionit për marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal nuk është e drejtë. Në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tropojë, në datën 5.3.2018, është bërë regjistrimi i procedimit penal nr. **/2018, bazuar në kallëzimin e bërë nga banorë të fshatit D, të njësisë administrative M, si dhe shoqatës “T”. Në këtë kallëzim pretendohej se nga ana e firmës ndërtuese është konsumuar vepra penale e falsifikimit të dokumenteve. Në cilësinë e prokurorit të çështjes kam kryer veprimet e mëposhtme hetimore:*
- Është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi A.M;
 - Është kërkuar marrja në pyetje e shtetases A.U në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, pyetje e cila nuk është bërë e mundur për shkak të mosparaqitjes më shumë se një herë të kësaj shtetaseje;
 - Janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale kallëzuesit;
 - Janë administruar certifikatat e vdekjes së shtetasve A.D dhe R.I;
 - Me shkresën numër ***, datë 21.5.2018, i janë kërkuar të dhëna Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor;
 - Është administruar shkresa “Kthim përgjigjeje” numër ***, datë 24.5.2018, e Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor;

- Është administruar shkresa numër ***, datë 6.6.2018, e Qendrës Kombëtare të Biznesit, me të cilën është depozituar kopje joorigjinale e dosjes së dorëzuar nga “D.E” në këtë institucion;
- Është administruar shkresa nr. *** prot., datë 3.5.2018, e Agjencisë së Basenit Ujor Drin-Bunë;
- Në përfundim të të gjitha veprimeve të mundshme hetimore nuk është bërë e mundur të gjendet procesverbali origjinal i datës 3.4.2013, i nënshkruar nga kryeplaku i fshatit D dhe përfaqësuesit e subjektit “D.E”.
- Është bërë ndarja e procedimeve penale në procedimin penal numër ** (objekt i këtyre shpjegimeve) dhe procedimi penal numër ***, i cili i është transferuar për kompetencë lëndore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në përfundim të veprimeve hetimore, nga ana e subjektit të rivlerësimit është arritur në konkluzionin se pavarësisht faktit që *prima facie* (ndonëse në mungesë të dokumentit origjinal), mund të arrihet në përfundimin se kemi elemente të veprës penale “falsifikim i dokumenteve”, por për shkak të mungesës së dokumentit origjinal dhe për shkak të pamundësisë së kryerjes së aktit të ekspertimit mbi këtë dokument është e pamundur që vepra penale t’u atribuohet personave të caktuar dhe këta të fundit të merren në cilësinë e pandehurit.

a. Neni 66, shkronja “ç” e Kodit Penal, e cituar nga ana e Komisionit në rezultatin e hetimeve, e lidh institutin e parashkrimit të ndjekjes penale jo me regjistrimin e procedimit penal, por me marrjen e cilësisë së të pandehurit. Në analizë të kësaj dispozite rezulton se duke marrë të mirëqenë faktin se vepra penale është kryer në datën 3.4.2013, parashkrimi i veprës penale për të pandehurit e mundshëm fillon nga data 4.4.2018. Sikurse konstatohet nga veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi penal, nga ana e subjektit të rivlerësimit është vijuar të kryhen veprime hetimore edhe përtej kësaj date, fakt që provon vullnetin e subjektit të rivlerësimit për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për dërgimin e shkelësve të ligjit përpara drejtësisë.

Në hapësirën kohore nga regjistrimi i procedimit penal (datë 5.3.2018) deri në datën e pamundësisë ligjore për vijimin e ndjekjes penale për shkak të parashkrimit (datë 4.4.2018) janë 30 ditë kalendarike, afat gjatë të cilit nuk është bërë e mundur nga veprimet hetimore të saktësohet individi, të cilit i atribuohet vepra penale e, për pasojë, edhe të regjistrohet ky individ në regjistrin e të pandehurve, regjistrim i cili do të evitonte zbatimin e institutit të parashkrimit. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk ka veprime në shkelje të nenit 66/ç të Kodit Penal. Përkundrazi, çdo veprim hetimor ndaj personave të dyshuar, por të paregjistruar në cilësinë e të pandehurve, përtej datës 4.4.2018, do të përbënte shpërdorim të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 248 të Kodit Penal.

- b. Element tjetër që duhet të mbahet parasysh, është fakti që procedimi penal është ndarë në dy procedime penale, duke bërë kështu të mundur që prokuroria të vijonte me procedimin, në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.
- c. Në përfundim, duhet theksuar se kërkesa për pushimin e procedimit penal i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në gjykatat e të dyja shkallëve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin numër ***, datë 10.9.2018, ka vendosur “pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë. Pushimin e procedimit penal numër *** të vitit 2018...”. Kundër vendimit kanë ushtruar ankim përfaqësuesit e shoqatës “T” etj. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin numër ***, datë 4.12.2018, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit numër **, datë 10.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”.
- d. Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve dokumentacionin mbështetës, si:
- vendimin numër ***, datë 10.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, së bashku me shënimin përkatës për vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Vlerësimi i Komisionit

175. Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit marrë në konsideratë dhe provat e depozituara prej tij, si dhe duke qenë se vendimmarrja e subjektit “Kërkesa për pushimin e procedimit penal” i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat e të dyja shkallëve, të cilat të dyja kanë disponuar me “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë nga Komisioni”, konstatohet se vendimmarrja e subjektit nuk është kryer në kundërshtim me ligjin material penal.

Denoncim i shtetasit K.B⁴⁰

176. Ky shtetas ka paraqitur një kallëzim kundrejt Prokurorisë së Elbasanit, e cila ndër vite me përgjigjet dhe vendimet për mosfillimin e procedimit penal për një çështje lidhur me një pronë të familjes së tij, pretendohet prej këtij shtetasi se ka elemente korruptive në gjykimin e dosjes.
177. Denoncuesi ka shpjeguar se disponon 5 vendime të prokurorisë në vite, të cilat janë të njëjta nga përmbajtja, thjesht ndryshon emri i prokurorit. Vendimi i fundit është i prokurorit Artur Ismajlukaj dhe denoncuesi pretendon se të gjithë prokurorët që kanë trajtuar çështjen, kanë marrë vendim pa u bazuar në një hetim të çështjes.
178. Në lidhje me këtë pretendim të ngritur nga denoncuesi, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit në prapësime

⁴⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.6.2023.

179. Subjekti ka shpjeguar se: *“Në kuadër të këtij kallëzimi penal, kallëzuesi K.B ka shpjeguar se “është në proces gjyqësor me shtetasin E.D.Ç dhe është në pritje të një vendimi gjyqësor për zgjidhjen e çështjes së tij”. Por duke parë që gjyqet zgjasin pafundësisht, kallëzuesi i është drejtuar prokurorisë për të zgjidhur hallin dhe problemin që ka të bëjë me tokën e tij. Kallëzuesi ka pretenduar se disponon të gjitha dokumentet që provojnë pronësinë mbi pronën “Reparti i tharjes”, e cila ndodhet në zonën kadastrale Elbasan në tokën e tij, por me status është shtetërore. Këtë pronë kallëzuesi kërkon ta privatizojë, por kjo pronë është marrë padrejtësisht me dokumente të falsifikuara nga E.Ç”. Në kuadër të këtij kallëzimi janë marrë deklarime nga shtetasi D.Ç, i cili deklaroi se: “Gjithashtu unë deklaroj se kjo çështje është hetuar më parë nga organi i Prokurorisë Elbasan dhe me vendimin “Për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2009”, prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan mbi bazën e kallëzimit të ardhur nga ZQRPP Tiranë në lidhje me këtë pronë ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprat penale “shpërdorim i detyrës” dhe “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248, 186/1 i Kodit Penal”.*
180. Pra, nga vetë deklaratimet e kallëzuesit rezultojnë dy fakte. Së pari, jemi në kushtet e një kallëzimi penal, i cili ka për qëllim të përdorë rrugën penale për të zgjidhur një çështje, e cila nuk po gjen zgjidhje nga ana civile. Ky është shkaku për të cilin kallëzuesi pas një periudhe 11-vjeçare i është drejtuar organit të prokurorisë me kallëzim penal. Së dyti, për të njëjtat fakte është regjistruar një procedim penal mbi bazën e një kallëzimi të ZQRPP-së, kallëzim i cili u është nënshtruar procedurave të hetimit dhe për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pushimin e procedimit penal. Ky vendim nuk është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat dhe faktet mbi të cilat bazohej kallëzimi, qëllimin e deklaruar të kallëzuesit dhe vendimet e pushimit të Prokurorisë, është vlerësuar se nuk jemi përpara shkaqeve ligjore për regjistrimin e procedimit penal. Për më tepër vlen të theksohet se shtetasi K.B mund t'i drejtohet gjykatës për vlerësimin dhe, në rast fundor, rrëzimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal.

Vlerësimi i Komisionit

181. Nga analizimi i shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas prapësimeve nuk rezultoi që subjekti të ketë vepruar në kundërshtim me ligjin procedural apo material penal, sikurse është pretenduar nga denoncuesi.

Vlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

182. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias⁴¹ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁴², të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e

⁴¹ Shihni opinionin nr. 824/2015 të Komisionit të Venecias.

⁴² Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim, si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

183. Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:

- a. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
- b. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.
- c. Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
- d. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

184. Bazuar në shkronjën “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

IV. Gjetje të tjera/Sjellja e magjistratit jashtë ushtrimit të funksionit

185. Bazuar në informacionet e përcjella nga institucionet ligjzbatuese, si dhe të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, për një hetim të thellë e të gjithanshëm, Komisioni ka hetuar dhe për disa persona, me të cilët është pretenduar se subjekti shoqërohej dhe ka kaluar në pikat kufitare të Tropojës.

186. Komisioni ka verifikuar kontaktet e subjektit me shtetasit si vijon:

187. Në lidhje me shtetasin D.M, rezultoi që subjekti nuk kishte asnjë udhëtim.

188. Prokuroria⁴³ dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë⁴⁴ kanë informuar se është regjistruar një procedim penal me nr. ** i vitit 2012 për veprën penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia”

⁴³ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2023.

⁴⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2023.

- dhe “mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga nenet 91 dhe 278/2 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit D.M, dosje e gjykuar.
189. Referuar akteve të dosjes, depozituar nga Prokuroria Tropojë⁴⁵, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore, në rastin e hetimit të shtetasit D.M.
190. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin⁴⁶ e vitit 4.12.2012, ka vendosur:
1. Pushimin e çështjes penale për veprën penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia”, për shkak se kjo vepër penale ishte amnistuar me ligjin nr. 107/2012, datë 8.11.2012.
 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit D.M për veprën penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak” dhe dënimin e tij me 10.5 muaj burgim.
 3. Në aplikim të nenit 406 të Kodit Penal, i pandehuri dënohet përfundimisht me 7 muaj burg. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 14.12.2012.
191. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve⁴⁷ ka informuar se shtetasi D.M rezulton i rehabilituar, pasi me vendimin nr. **, datë 4.12.2012, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprat penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia” dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”.
192. Për shtetasin D.M subjekti ka shpjeguar në prapësime se e njeh për shkak të lidhjes shoqërore të hershme me të vëllain e tij, shtetasin B.M, pasi janë njohur dhe shoqëruar që në kohën e shkollës së mesme. *“Në vitin 2012, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është regjistruar procedimi penal numër **/2012 me të pandehur shtetasin D.M, i dyshuar për veprën penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia” dhe “mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga nenet 91 dhe 278/2 të Kodit Penal. Veprimet hetimore në lidhje me këtë çështje më janë deleguar në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore”.*
193. Subjekti ka shpjeguar se: “Në vitin 2012, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, organika përbëhej nga 1 drejtues prokurorie, 1 prokuror dhe 1 oficer i policisë gjyqësore (subjekti i rivlerësimit), vërtetuar ky fakt nga vërtetimi nr. *** prot., datë 19.4.2023, lëshuar nga Prokuroria Tropojë. Në rastin objekt hetimi kishte dyshime të arsyeshme se ishin përfshirë edhe punonjës të Policisë së Shtetit, veprimet hetimore u realizuan nga të gjitha strukturat e Prokurorisë.
194. Me ngarkimin e detyrës nga prokurori (drejtuesi i Prokurorisë dhe njëkohësisht edhe prokurori i çështjes) subjekti i rivlerësimit e ka informuar verbalisht për ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit për shkak të njohjeve dhe marrëdhënieve shoqërore me të vëllain e shtetasit të dyshuar. Për shkak të rrethanave të ngjarjes, dyshimeve për përfshirjen e punonjësve të policisë dhe strukturës së cinguar të Prokurorisë, nga ana e prokurorit të

⁴⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2023.

⁴⁶ Nr.***, datë 4.12.2012.

⁴⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2023.

çështjes edhe me mirëkuptimin e subjektit të rivlerësimit është vendosur që veprimet hetimore të kryheshin nga ky i fundit. Gjatë fazës hetimore, nga subjekti i rivlerësimit janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për dokumentimin dhe mbështetjen me prova të fajësisë së të pandehurit. Veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit çuan në përfundimin me sukses të çështjes penale dhe në dënimin e autorit të veprës penale me vendimin nr. **, datë 4.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

195. Nga analiza e këtij vendimi rezulton se nga dy vepra penale për të cilat akuzohej i pandehuri, Gjykata ka vendosur ta dënojë këtë të fundit për veprën penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak”. Pavarësisht dokumentimit dhe provimit nga ana e prokurorisë edhe për veprën tjetër penale për të cilën akuzohej i dyshuari, gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur pushimin e çështjes penale për veprën penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal, për shkak se kjo vepër penale ishte amnistuar me ligjin nr. 107/2012, datë 8.11.2012, shpallur me dekretin numër ***, datë 19.11.2012, të Presidentit të Republikës.
196. Vlen të theksohet se vepra penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia” hyn në kategorinë e veprave penale që ndiqet me kërkesë/ankim të të dëmtuarit. Ky i fundit ka marrë pjesë në fazën hetimore dhe në atë gjyqësore, është njohur me veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit dhe vendimin e gjykatës dhe nuk ka kryer veprime që të dëshmojnë kundërshtime apo kërkesa në lidhje me procedimin penal, veprimet hetimore dhe vendimin e gjykatës. Për sa më sipër, veprimet e subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara edhe nga vendimi i Gjykatës, provojnë se ky i fundit është sjellë në përputhje me etikën e oficerit të policisë gjyqësore, zbatimin korrekt të ligjit dhe shmangien e konfliktit të interesit”.
197. Në lidhje me shtetasin A.Z rezulton se subjekti ka dy dalje, me automjetin në pronësi të këtij shtetasi, në datat 2.12.2013 dhe 9.2.2014. Subjekti nuk ka udhëtime me këtë shtetas.
198. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se shtetasi A.Z në vitin 2007⁴⁸ është akuzuar për veprën penale “kontrabandë me mallra të tjerë në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 174-25 të Kodit Penal.
- Subjekti i rivlerësimit në këtë çështje është përfshirë në veprime hetimore, kur ushtronte detyrën e OPGJ-së. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nr. **, datë 7.12.2007, shtetasi A.Z dhe një shtetas tjetër janë deklaruar fajtorë për veprën penale të “kontrabandës me mallra të tjerë në bashkëpunim”, të cilët janë dënuar me gjobë. Ky vendim mori formë të prerë në datën 17.12.2007.
199. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve⁴⁹ ka informuar se shtetasi A.B.Z, i datëlindjes 22.9.1983, rezulton i rehabilituar, pasi është deklaruar fajtor⁵⁰ për veprën penale të “kontrabandës me mallra të tjerë”.

⁴⁸ Referuar akteve, depozituar nga Prokuroria e Tropojës me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2023.

⁴⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2023.

⁵⁰ Me vendimin nr. **, datë 7.12.2007, të Gjykatës Tropojë.

200. Për shtetasin A.Z, subjekti ka shpjeguar në prapësime se: *“Kam njohje me këtë shtetas, e cila daton përpara dënimit të tij. Ky shtetas është dënuar në vitin 2007 për veprën penale “kontrabandë me mallra të tjerë”. Veprimet hetimore për dokumentimin dhe provimin e kryerjes së veprës penale janë kryer prej meje. Fakti që i pandehuri është dënuar nga Gjykata për një vepër penale për të cilën veprimet dhe procedurat hetimore janë realizuar nga subjekti i rivlerësimit, vërteton se nuk jam ndikuar në kryerjen e detyrës nga marrëdhëniet e njohjes me këtë shtetas. Vendimi i Gjykatës e ka dënuar shtetasin A.Z me gjobë, çka provon edhe rëndësinë e veprës penale në raport me shkeljen e ligjit. Në vijimësi, pas marrjes së këtij dënimi, shtetasi A.Z ka ushtruar funksione të ndryshme në administratën publike të qytetit të Bajram Currit, fakt që provohet nga aktet administrative bashkëlidhur këtyre shpjegimeve dhe që vërtetojnë rehabilitimin edhe shoqëror, përveçse penal të këtij shtetasi”.*
201. Në lidhje me shtetasin S.K, subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2016 ka pasur në përdorim automjetin në pronësi të shtetasit S.K me targë AA *** NC.
202. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve⁵¹ ka informuar se shtetasi S.A.K, i datëlindjes 19.3.1971, rezulton i rehabilituar, pasi është deklaruar fajtor në vitin 1992⁵² për veprën penale të “vjedhjes së pasurisë shtetërore”.
203. Në lidhje me shtetasin S.K subjekti ka shpjeguar se, ka njohje dhe lidhje familjare me të. Pretendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dijeni për vendimin e dënimit të vitit 1992, kohë në të cilën nuk jetonte në Tropojë dhe ishte në moshën 13-vjeçare, nuk është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka pasur kontakte me shtetasin S. K në një kohë shumë të mëvonshme se vendimi i tij i dënimit, e për më tepër në një periudhë në të cilën ky shtetas rezulton i rehabilituar.
204. Në lidhje me shtetasin N.L, rezulton se subjekti ka udhëtuar me këtë shtetas në datën 28.9.2016, me automjetin me targë AA *** NC, në pronësi të S.K, që në këtë periudhë përdorej nga subjekti i rivlerësimit.
205. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve⁵³ ka informuar se shtetasi N.M.L, i datëlindjes 25.11.1985, rezulton i rehabilituar me vendim të Gjykatës së Lartë, datë 11.4.2022, pasi:
- me vendimin nr. *, datë 17.1.2007, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “plagosjes së lehtë me dashje” dhe “plagosjes me dashje të kryer në bashkëpunim”
 - me vendimin nr. **, datë 8.7.2008, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale “goditje për shkak të detyrës kryer në bashkëpunim”
206. Për shtetasin N.L subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, ka njohje me këtë shtetas për shkak të lidhjes familjare që ky i fundit ka me shtetasin S.K. Me përjashtim të udhëtimit të datës

⁵¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2023.

⁵² Me vendimin nr. **, datë 1.2.1992, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵³ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2023.

- 28.9.2016, nuk ka takime të tjera me këtë shtetas. Për sa i përket udhëtimit të datës 28.9.2016, theksojmë se ky udhëtim është kryer për nevoja personale të tij dhe për shkak të përdorimit të automjetit të shtetasit S.K është marrë shtetasi N.L në cilësinë e drejtuesit (shoferit) të automjetit. Sikurse rezulton nga rezultatet e hetimit administrativ ai nuk ka pasur kontakte të mëparshme apo të mëpasshme me këtë shtetas, me përjashtim të kontaktit rastësor të datës 28.9.2016.
207. Në lidhje me shtetasin G.M, nga dokumentacioni bankar ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka transferuar një shumë prej 1.000.000 lekësh tek ky shtetas.
208. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve⁵⁴ ka informuar se shtetasi G.S.M, i datëlindjes 1.12.1972, rezulton i rehabilituar, pasi me vendimin nr. .**, datë 31.3.1999, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale “përvetësim i pasurisë shtetërore në bashkëpunim”, si dhe veprës penale “armëmbajtje pa leje”.
209. Në lidhje me shtetasin G.M, subjekti ka shpjeguar se: *“konstatoj se në relatimin e fakteve dhe datave nga ana e Komisionit ka një gabim material në datën e dënimit të këtij shtetasi. Vendimi i dënimit të tij është i viti 1991 dhe jo i vitit 1999, sikurse relaton Komisioni. Për më tepër në vitin 1999 ky shtetas rezulton të ketë qenë me banim të përkohshëm në Republikën Federale Gjermane. Veprimi i transferimit të vlerës prej 1.000.000 lekësh është kryer në vitin 2011 dhe përkon me veprimet financiare për shlyerjen e detyrimeve për blerjen e apartamentit të banimit në Tiranë. Në këto kushte, kjo transfertë është një veprim financiar i dokumentuar dhe me burime financiare të ligjshme”.*
210. Komisioni e ka trajtuar këtë transfertë në pikën 43 e në vijim të këtij vendimi, nga ku rezultoi se këto likuiditete janë me burim “dhuratë” nga vjehri i subjektit. Trupi gjykues i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me marrëdhënien me këtë shtetas dhe qëllimin e transfertës.
211. Në lidhje me shtetasin F.K, referuar të dhënave të sistemit TIMS, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka një udhëtim me këtë shtetas në datën 15.2.2016. Në datën e udhëtimit shtetasi K ka qenë vetëm 18 vjeç.
212. Për shtetasin F.K, rezulton se Gjykata Themelore e Gjakovës, me vendimin e datës 22.9.2021, ka lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar për këtë shtetas, pasi nga dënimi i caktuar për të, prej 9 (muaj) burg i ka mbetur për të vuajtur 5 muaj, për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, informacion i bërë publik në median online dhe i konfirmuar nga Komisioni.
213. Për shtetasin F.K, nga dokumentacioni i depozituar nga Prokuroria e Përgjithshme⁵⁵ rezulton një korrespondencë ndërmjet këtij institucioni dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.

⁵⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2023.

⁵⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2023.

214. Prokuroria Tropojë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2019, të nënshkruar nga drejtuesi A.Sh, kanë dërguar materialet në ekzekutim të letërporosisë së autoriteteve gjyqësore të Kosovës për shtetasin F.K (nuk ka akte bashkëlidhur, vetëm kjo shkresë rezulton e ardhur pranë Komisionit nga Prokuroria e Tropojës).
215. Në lidhje me shtetasin F.K subjekti ka shpjeguar se: *“Në këtë rast vlen të theksohet se nuk kam pasur njohje të mëparshme apo të mëpasshme me këtë shtetas. Nuk rezultojnë kontakte të tjera, përveç kontaktit të rastësishëm të datës 15.2.2016, i cili në kujtesën time është për shkak të një ndihme të dhënë ndaj një nxënësi për kthimin e tij në shtëpi pas përfundimit të ditës së shkollës. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të konsiderohet sikur ka pasur kontakt të papërshtatshëm me këtë shtetas, për sa kohë që në momentin e regjistrimit të takimit ky i fundit nuk rezultonte i dënuar apo nuk disponohen informacione se ishte i përfshirë në veprimtari kriminale. Sjellja e mëpasshme kriminale e shtetasit nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi për kontakt të papërshtatshëm subjektin e rivlerësimit, për aq kohë sa nuk provohet, në kuptim dhe zbatim të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 se ky kontakt ishte subjekt i veprimtarisë kriminale”.*
216. Në lidhje me shtetasin P.Ç, nga hetimi nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të kishte ndonjë udhëtim me këtë shtetas.
217. Komisioni ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve⁵⁶ për gjendjen gjyqësore të këtij shtetasi, i cili rezulton i dënuar për disa vepra penale, por jo për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për ta klasifikuar si person të përfshirë në krimin e organizuar.
218. Referuar të dhënave të gjeneruara nga sistemi i AMF-së, rezulton se P.C(Ç) nuk ka pasur në pronësi të tij automjete, por ka qenë përdorues i disa automjeteve.
219. Nga hetimi i Komisionit:
- ✓ nuk rezultoi që subjekti të ketë udhëtuar me asnjë nga automjetet në përdorim të shtetasit të mësipërm.
220. Në lidhje me shtetasin A.K, Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë/Gjykatës mbi procedime penale të regjistruara në ngarkim të këtij shtetasi, nga ku rezultuan 2 procedime të regjistruara, për veprat penale “konkurrencë e pandershme” në vitin 2017 dhe vepra tjetër “goditje për shkak të detyrës”, regjistruar në vitin 2008. Procedimi i fundit është pushuar.
221. A.K, i akuzuar për veprën “konkurrencë e pandershme”, pas procesit gjyqësor është shpallur i pafajshëm.
222. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve⁵⁷ ka informuar se A.A.K, me vendimin nr. **, datë 20.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është deklaruar i pafajshëm, për veprën

⁵⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.6.2023.

⁵⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2023.

penale “konkurrencë e pandershme”. Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur mospranimin e ankimit të Prokurorisë së Tropojës.

Konstatime të Komisionit

223. Komisioni, pas një hetimi të gjithanshëm të veprimtarisë dhe sjelljes së subjektit të rivlerësimit në lidhje me shtetasit e mësipërm, njohjet apo udhëtimet e subjektit me këta shtetas, konstatoi se:

- shoqërimi i subjektit me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme dhe të dënuar për vepra penale, ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

224. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 2, neni E i Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit në prapësime

225. Subjekti i rivlerësimit në prapësime, si dhe gjatë hetimit, ka shpjeguar dhe ka deklaruar njohjen dhe llojin e marrëdhënieve që ka pasur me këta persona.

226. Subjekti i ka kërkuar Komisionit që në vlerësim të kësaj situatë të merren parasysh faktet vijuese:

- Familja e tij banonte që në vitin 2003 në Tiranë dhe ai ushtronte detyrën e OPGJ-së në Tropojë, për këtë shkak ka pasur udhëtime të shumta vajtje-ardhje.
- Rruga automobilistike për të shkuar në Tropojë ishte në kushte teknike jo të mira dhe e pakalueshme, fakt ky i njohur që udhëtarët përdorin pikat kufitare të Kosovës (Qafë-Morinë, Qafë-Prush), për të shkuar në qytetin e Tropojës.
- Fakti i distancës së madhe të familjes me vendin e punës, mungesa e një automjeti në pronësi të tij, si dhe për shkak të detyrës, si dhe qenia për disa vite si OPGJ i vetëm në Prokurorinë e Tropojës, ka pasur të nevojshme udhëtimin në orare kur nuk kishte transport publik. Për këto shkaqe ka udhëtuar me persona të ndryshëm, shpeshherë dhe të rastësishëm.
- Subjekti ka kërkuar nga Komisioni që në vlerësim të kësaj situatë të merret parasysh edhe fakti që subjekti i rivlerësimit ka lindur dhe është rritur në rrethin e Tropojës, në një familje të madhe nga ana numerike (5 vëllezër, 2 motra dhe 20 kushërinj të parë). Për shkak të lidhjeve familjare dhe shoqërore, jetesës për një kohë shumë të gjatë në të njëjtin komunitet, ndodh rëndom që të krijohen kontakte të rastësishme me persona të vlerësuar nga Komisioni si të papërshtatshëm apo që vijnë në kundërshtim me sjelljen etike të një magjistrati.

227. Për këto shkaqe, subjekti ka shpjeguar dhe ka depozituar në mbështetje të shpjegimeve të tij dy kërkesa⁵⁸ drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe një kërkesë drejtuar KLP-së⁵⁹ për t’u transferuar nga qyteti i Tropojës në një rreth tjetër. Në përmbajtje të të tria këtyre kërkesave,

⁵⁸ Me shkresat nr. *** prot., datë 28.10.2011 dhe me nr. *** prot., datë 31.1.2014.

⁵⁹ Me shkresën e datës 20.1.2021, me objekt “Kërkesë për transferim”.

subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që të transferohet në një prokurori tjetër sa më afër Tiranës, pasi aty ndodhej familja e tij dhe puna në rrethin e Tropojës kishte bërë që të ishte larg familjes për kohë të gjatë.

228. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar në kërkesat e tij se ka kaluar një kohë të gjatë në rrethin e Tropojës dhe, duke qenë i vetëm në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore, që nga viti 2010 e në vazhdim mendonte se ishte konsumuar si profesionalisht edhe nga ana sociale, pasi në shumë raste nga vetë ai është kërkuar zëvendësimi i tij në procedimet penale në hetim, për faktin e lidhjeve farefisnore dhe shoqërore, gjë e cila i ka vështirësuar shumë mbarëvajtjen e punës në këtë prokurori.

Vlerësimi i Komisionit mbi sjelljen e magjistratit jashtë funksionit

229. Komisioni nga hetimi i kryer evidentoi shoqërimin e subjektit me shtetas të dënuar për vepra të ndryshme penale, trajtuar sa më sipër. Kjo sjellje e subjektit ndikon negativisht në figurën e magjistratit dhe cenon standardet e sjelljes së tij, etikën në punë dhe angazhimin ndaj vlerave. Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kish treguar kujdesin e duhur për të ruajtur të pastër në sytë e publikut figurën e magjistratit.

230. Në analizim të të gjitha rrethanave të mësipërme, si dhe fakteve të parashtruara nga subjekti, të dhënat e rezultuara nga hetimi i çështjes janë të pamjaftueshme, për të konkluduar se subjekti ndodhet në kushtet e “cenimit të besimit të publikut”, dhe ndaj tij duhet të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra. Komisioni vlerëson se kjo sjellje e subjektit duhet parë dhe vlerësuar lidhur me kriteret e vlerësimit, në raport me gjetjet e rezultuara nga hetimi për kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe atë të aftësive profesionale. Shoqërimi i subjektit me persona me precedentë penalë, në kushtet kur nuk rezultuan problematika të tjera serioze në të tria kriteret, është e pamjaftueshme për Komisionin për të aplikuar nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

231. Komisioni ka vlerësuar se sjellja e subjektit, mungesa e kujdesit të treguar prej tij dhe shoqërimi me persona të dënuar për vepra të ndryshme penale është shqetësues dhe nuk duhet të ngelet pa u trajtuar. Ligji nr. 84/2016 nuk ka të parashikuar dispozita ligjore në lidhje me shkelje të tilla të kryera nga ana e subjektit, pasi me ligj janë kompetencë e një institucioni tjetër.

232. Komisioni i është referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën “ç” të nenit 103, me titull “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”, ku parashikohet se: *“Sipas parashikimeve të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 101 të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit, si vijon: ç) shoqërimi me persona që janë në ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar ose persona të cilët janë të afërm me magjistratin në lidhje gjaku ose me ligj dhe pasja e marrëdhënieve të biznesit të papërshtatshme me këta persona.*

233. Për këtë arsye, konstatimet e Komisionit në lidhje me sjelljen e subjektit të rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit, të parashikuara në nenin 103 e vijues të ligjit nr. 96/2016, do t'i përcillet për kompetencë ILD-së për vlerësime të mëtejshme, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Artur Ismajlukaj.
2. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent ILD, bazuar në nenin 103/ç, mbi “sjelljen e magjistratit jashtë ushtrimit të funksionit” të ligjit

nr. 96/2016; për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit.

3. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 7.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha